

“Kaprolla” Permbledhje jo teknike rraportit .

## PERMBLEDHJE JO TEKNIKE E RAPORTIT

Shfrytezim miniere per nxjerrje mineral kromi,  
objekti “Galerite Nr.10-15 Bater” Miniera Bater -Martanesh  
Subjekti “Kaprolla“ sh.p.k



MAJ 2022

## **Permbajtja**

- 1- Vend ndodhja e objektit, pershkrim i veprimtarise, perdorimi i tokes e burimeve te tjera natyrore
- 2- Pershkrim i shkarkimeve te mundeshme ne uje, toke dhe ajer
- 3- Mjedisi ne zone, e ndikimet e mundeshme nga veprimtaria
- 4- Masat per parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis nga veprimtaria
- 5- Informacion mbi lidhjene projektit me projekte fqinje.
- 6- Pjesa ndertimore dhe ajo ekonomike

## Permbledhje jo teknike e raportit

### -1- Vend ndodhja e objektit, pershkrim i veprimtarise, perdorimi i tokes e burimeve te tjera natyrore

Projekti qe kerkohet te zbatohet nga subjekti juridik “KAPROLLA” sh.p.k, me administrator zotin Qamil HIDRI, ka per qellim pergatitjen dhe shfrytezimin e rezervave minerale te kromit ne objektin e kromit “Galerite Nr.10-15 Bater”, Bater-Martanesh, rrethi Bulqize.

Objekti ndodhet ne zonen administrative ne rrethin e Bulqizes, komuna Martanesh rreth 0,2 km larg nga rruga automobilistike rurale Lycane-Bater- Lugu i Gjate poshte rruges ne anen e djathte te saj.

Kjo miniere qe kerkohet per shfrytezim ndodhet ne shpatin jug-perendimor te Batres rreth 100 m mbi rrjedhen e zallit te limones ( Batres).

Njekohesisht objekti ka mundesi lidhje me rruge makine e cila deri ne Bater eshte e pjesisht e mirembajtur, ndersa pjesa tjeter deri ne afersi te tij ( rreth 0,2 km ) kerkon zgjerime dhe mirembajtje.

Zona me afert jane fshati Gjon ( Kotaj) e qytezes se Krastes krahina e Martaneshit.

Ky vendburim ka qene zbuluar dhe shfrytezuar vite me pare, ku eshte punuar me punime siperfaqesore kerkim-zbulimi shoqeruar me kanale gjeologjike e deri ne galeri shfrytezimi nga ish ndermarrja minerare Bater.

Nga keto punime u moren disa rezultate pozitive si ne kaniere dhe nentoke me nje permbajtje te komponentit te dobishem ne shpimet e zbulimit deri 41 %  $Cr_2O_3$ , ne kanal e galeri 24 %  $Cr_2O_3$ , por me nje sasi te konsideruar rezervash kjo per shkak te intensitetit te larte te krekim-zbulimit, shfrytezimit nder vite dhe natyres se trupit xeheror. Sherbimi gjeologjik ne Burrel, ka punuar perpara viteve 62-te per kerkim –zbulim te mineralit te kromit ne kete zone.

Me tej rreth viteve 1964 ka filluar hapja e punimeve te para minerare ( galerive) te cilat kane vazhduar derin ne vitet 1989 dhe me vone u nderpre aktiviteti shtetror duke u privatizuar e qe vazhdojne te jene ne aktivitet edhe sot nga subjete private qe operojne ne kete zone. Objekti qe kerkohet te merret leja mjedisore perfaqeson nje objet (zone) minerare me punime te hapura me pare rreth viteve 1964 te braktisura me vone si pasoje e hapjes se punimeve te tjera minerare me te thella dhe keto punime u abandenuan per tu vazhduar me vone nga subjektet private.

Pas ketij viti e deri tani ka qene e mbyllur, per arsye te mos perballimit te konkurences ne treg si rrjedhoje nder te tjera e renies se cmimit te kromit ne tregun nderkombetar etj.

**b-Qellimi;** Projekti ka qellim pergatitjen dhe shfrytezimin e ketij vendburimi kromi, ‘Galerite Nr.10-15 Bater’ v.burimi Bater i cili do te behet ne zbatim te kuadrit ligjor ne fuqi vecanerisht ne fushen e mjedisit dhe minierave. Ne projekt jane pasqyruar te gjitha etapat e ringritjes ,pastrimit ,armatimit dhe hapjet e punimeve te reja minerare ,kapitale ,kerkimore, pergatitore te trasmetuara ndermjet kapitujve dhe tabelave te vacant ne menyre shume te sakte dhe te detajuar, ne vite si per prodhimin e minerali te kromit dhe per sasine e sterileve qe do te nxirren nga hapja e punimeve dhe ringritjet, gjithashtu jane te saktesuara ne projekt dhe gjatesia e rruges qe do te hapet dhe sheshi i depozitimit te mineralit dhe sterilit.

Per te pasqyruar sa me mire qellimin, projektuesit ne fillim kane paraqitur nje kapitull ku jepen te dhenat mbi vend-ndodhjen e objektit, gjeografine, klimen, infrastrukturen dhe ekonomine e zones.

Projekti vazhdon me ndertimin gjeologjik i cili paraqet detaje dhe pershkrimin gjeologjik te zones e v.burimit si zone ne te cilen formacionet gjeologjike jane te pershtateshme per shfrytezim me punime minerare.

Hapja dhe shfrytezimi i mineralizimit te kromit detajohen ne kapitullin e shfrytezimit, ku jepen hollesira mbi sistemin e shfrytezimit me te gjitha karakteristikat e tije, fushen minerare, lartesine e kateve dhe te n/kateve te shfrytezimit, numurin e punetoreve, kapacitetin e prodhimit ne vite, menyra e shperthimit te minave etj.

Per te hapur dhe ringritur te gjitha punimet minerare qe jane te abandonuara mbi 38 vjet ne horizontet e galerise 10-15 deri ne kuoten +1440 jane te parashikuara ne project ne tabela te vecanta dhe ne grafikun e realizimit te te ardhurave dhe shpenzimeve.

Ana financiare fillon me planifikimin e investimeve dhe problemet e tjera ekonomike. Çeshtjet ekonomike paraqesin me ane te llogaritjeve dhe tabelave perkatese qellimin e projektit dhe garantojne ecurine normale te punes.

## “Kaprolla” Permbledhje jo teknike rraportit .

Sa me siper duke u mbeshtetur ne bazen ligjore, konkretisht ne ligjin minerare Shqiptare nr. 10 304, dt 17.07.2010, subjekti ka hartuar projektin per shfrytezimin e mineralit te kromit ne objektin “Galerite Nr.10-15 Bater” ne v.burimin Bater rreth Bulqize.

Qellimi kryesor dhe i vetem i projektit eshte qe te shfrytezoje mineralin e kromit me punime minerare te kombinuara siperfaqsore me kariere dhe nentoksore ne vartesi te te dhenave gjeologo-minerare te vazhdoje shtimin e rezervave dhe te prodhimit te tyre ne sasi dhe cilesi.

Venia ne shfrytezim e kesaj miniere eshte me nje vlere te kenaqshme investimi, e nderkohe krijon kushte optimale per rritjen e efektivitetit te shfrytezimit te mineralit te kromit, perballe nje tregu mjaft te favorshem.

Bazuar ne rezervat minerare, te ketij vendburimi dhe kondicionin ekonomik, ne projekt jane zgjedhur trupat minerare me kushte te favorshme, me permbajtje optimale te kromit ne xeheror, per nje treg konkurses.

Projekti eshte ne sinkron te plote edhe me strategjine kombetare te zhvillimit te industrise nxjerrse e perpunuese ne te cilen ben pjese dhe ze nje peshe te madhe edhe industria e kromit nder me te vjetrat e me tradite ne vendin tone. Elementet e zgjedhur ne pergatitje dhe shfrytezim te tij, jane bashkekohore, duke permiresuar menyren e shfrytezimit, rritur shkallen e mekanizimit, treguesit e nxjerrjes nga nentoka, si factor pozitiv edhe ne lidhje me problemet mjedisore, per objekte te tilla. Ky projekt ndikon pozitivisht edhe ne zbutjen e problemeve te mprehta sociale ne kete zone.

### 1.2 Pozicioni gjeografik i objektit.

Objekti i kromit “Galcite Nr.10-15 Bater” nga kuota +1400- 1440 m deri ne siperfaqe, ndodhet ne VL te qytetit te Krastes dhe ben pjese ne planshetin topografik me nomenklature K-34-89-C-b te shkalles 1:25 000

Objekti i kromit “Galerite Nr.10-15 Bater” nga kuota +1400- 1440 m deri ne siperfaqe ndodhet rreth 0.6 km ne vije ajrore larg ne jug-perendim te ish sektorit ( Kampit) te Batres.

Zona e minerare kufizohet ne lindje e Juge lindje me perroin e Batres (100m larg), ne veri me ish minieren e Batres ( 0.4 km larg), ne jug-perendim me Ish Minieren Bater ( Zona e RF).

Ne veri dhe verilindje te objekti ne nje disatance ajrore prej rreth 200 m kalon rruga automobilistike, qe lidh objektin me zona te tjera ne shfrytezim si dhe ne distance gati 0,2 km ne Jug-lindje te tij kalon rruga qe lidh minieren e Batres me Lugun e Gjate, Batren Jugore- Fushe Kaltin me Krasten , Bizen , Elbasanin dhe Tirancen .

Koordinat kufizues te zones se kerkuar jepen ne tabelen emeposhteme ( tabela Nr 1)

Tabela Nr 1 Koordinatat e pikave qe kufizojne zonen e shfrytezimit

Koordinatat sistemi Gaus-Kryge

Nr. Pikave	Koordinata		
	X	Y	Z
1	45 91 125	44 36 440	1400+1440
2	45 91 125	44 36 625	1400+1440
3	45 91 580	44 36 620	1400+1440
4	45 91 740	44 36 700	1400+1440
5	45 91 800	44 36 683	1400+1440
6	45 91 800	44 36 440	1400-+1440

**Madhesia e sipërfaqes se konturuar brenda pikave kufitare me koordinatat perkatese te dhena ne tabelen me lart eshte 0,0116 km<sup>2</sup>**

Koordinatat sistcemi KRGJSH

Nr. Pikave	Koordinata		
	Y	X	Z
1	519867.698	4590740.506	1400+1440
2	520052.676	4590742.643	1400+1440
3	520042.419	4591197.531	1400+1440
4	520120.561	4591358.436	1400+1440
5	520102.869	4591418.233	1400+1440
6	519859.899	4591415.425	1400+1440

**Siperfaqja e Zones Minerare S= 0.0116 KM<sup>2</sup>**

### 1.3 -Gjeografia e zones.

Zona e kerkuar per marrjen e lejes minerare se shfrytezimit te mineralit te kromit ne vendin quajtur: **“Galerite Nr.10-15 Bater ”** eshte vazhdimesi e vendburimit te kromit Bater .

Zona ndodhet rreth 0,2 km larg ne vije ajrore ne jug-lindje te minieres ekzistuese te Batres Qendra me e madhe e banuar eshte qyteza e Krastes qe ndodhet rreth 5 km larg ne vije ajrore ne jugperendim te objektit .

Ne lindje objekti ne nje distance ajrore prej rreth 100 m kalon rruga automobilistike, qe lidh minieren e Batres me Lugun e Gjate, Ternoven si dhe ne Jug Krasten-Ballenjen , Bizen , Elbasanin dhe Tiranen .


Zona e kerkuar paraqitet ne hartën topografike ne shkalle 1: 25 000 dhe kufizohet kufizohet nga poligoni me koordinatat sipas tabelës Nr 1:

Ne jug-perndim te zones se kerkua kalon perroi i Limones ( Batres), i cili ka uje pothuajse gjate gjithë vitit mbasi mbledh ujrat qe rrjedhin nga liqeni artificial i Sopeve. Kryerja e punimeve ne kete objekt minerare nuk ka ndikim ne rrjedhen e ketyre ujrave si ne cilesine e tyre ashtu dhe ne sasine ( prurjen).


### a)- Pershkrimi i relievit

Njesite themelore te relievit te krahines se Martaneshit jane Mali i Dhoksit (+2020m) ,mali i Kaptines se Martaneshit, mali i Synoit,lugina e Bulqizes dhe pjesa me e siperme e lugines se matit.Format e relievit jane te ndryshme , nga ato te trasheguara deri tek ato ne formim e siper. Thellesia e coptimit te tije eshte pergjithesisht e vogel.Relievi paraqitet malor dhe i thyer me shpate te pjerrta, ujenares te valezuar dhe morfologji disi te rregullt.

Duke filluar nga kuota me e larte relieve ulet gradualisht ne te gjitha anet duke krijuar ne kete menyre mundesi qe rrjeti hidrografik te shperndahet ne shume drejtime . Ne pergjithesi e gjithë zona ka lartesi nga niveli i detit mbi 1400-1500 ml



Harta fizike e objektit



#### b) - Klima.

Zona, ku ben pjese objekti minerar per te cilin po hartohet projekti, karakterizohet nga klima tipike kontinentale, me vere relativisht te shkurter, te fresket dhe me reshje te pakta. Stina e dimrit eshte e gjate, e ftohte dhe me reshje te bollshme bore. Reshjet ne vere jane ne forme shiu dhe bresheri , shpesh me stuhi, qe jane mjaft tipike per zonat e thyera malore me kuota mbi +1400 ml, Gjate stines se dimrit rreshjet jane ne forme shiu dhe kryesisht debore, trashesia e se ciles, shpesh kalon mbi 100 cm, teper rralle deri 2-3 m. Temperaturat ne vere arrijne deri +25 grade C, ndersa ne dimer ato shkojne deri ne -20 grade C.

Debora fillon te bjere qe ne fundin e muajit Nentor dhe vazhdon, pothuajse pa nderprerje deri ne muajin Mars. Ky teritor, pothuajse gjate gjithë vitit, por vecanerisht ne periudhen fundi i vjeshtes-fillimi i pranveres, rihet nga erera shume te ftohta. Kjo gje do te coje domosdoshmerisht ne nderprirjen e punes nga subjekti i licensuar per periudhen dhjetor-mars te cdo viti.

#### c)- Reshjet

Sasia mesatare vjetore e reshjeve arrin ne 1260 mm ne vit ndert te cilet nje pjese e madhe e tyre bie ne forme debore. Shperndarja e tyre gjate vitit eshte e ndryshme sasia me e madhe e tyre bie gjate stines se pranveres dhe fundi i vjeshtes e dimrit dhe me pak ne muajt e veres. Muajt me te laget jane Nentor-Dhjetor dhe Janar Maj me 160 mm-140 mm. Muajet me te thate jane Korrik –Gusht me 45-50 mm. Mesatarja e diteve me reshje  $\geq 11$  mm dhe ne dite me reshje per zonen eshte rreth 48-50 dit ne vit.

Duke pasur parasysh sasine maksimale per 24 ore te reshjeve dhe intensitetin per interval te ndryshme kohe, kjo zone karakterizohet me intensitet te ulet te reshjeve. Sasia maksimale e reshjeve e regjistruar ne kete zone eshte rreth 126 mm ne 24 ore.

#### Debora

Renia e debores ne kete teritor eshte dukuri e zakonshme per cdo vit. Kjo dukuri verehet me teper ne muajit e dimrit, por ka raste dhe te renies se saj ne muajet Tetor dhe Prill. Lartesia e shtreses se bores varion nga 50 cm deri ne 1,5 apo 2m ne zonat e larta. Periudha me shtrese bore zgjat 60-80 dit ne vit, ndersa ne pjeset e larta dhe 90 dite.

#### 1.4 Ndertimi gjeologjik I objektit.

Objekti i i kromit "Galerite Nr.10-15 Bater" ndodhet ne zonen qendrore te fushes harzburgitike te Batres se Martaneshit dhe ne zonen afer qendrore te masivit ultrabazik te Bulqizes. Mineralizimi i kromit, i vertetuar nga punimet fushore, ben pjese ne horizontin e siperm te mineralizuar te vendburimit Bater dhe vendoset ndermjet

shkembinjve harcburgitike- dunitike. Dalje te tilla linzore kane permasa te kufizuara ne shtrirje dhe renie dhe nuk kane asnjë lidhje me krahet e mineralizuar te trupit kryesor kromitik te vendburimit Bater. Harcburgitet dhe me pak Dunitet jane shkembinjte kryesore qe mbulojne objektin, kjo nga te dhenat e punimeve te kryera nga siperfaqja me objekt kerkim-zbulimin e daljeve xeherore te kromit te vendburimit Bater.

**Peridotitet** (Harcburgitet) Keto shkembinj zene siperfaqen me te madhe e perfaqesojne ne vetevete shkembinj massive, me ngjyre te gjelber te erret rralle te celur. Shpesh here , sidomos ne pjesen qendrore –jugore e veriore te saje ndeshen harcburgitet me teksture brezore. Karakteristike eshte fakti se si pasoje e veprimit te proceseve te erozionit (kryesisht te perpunimit fiziko-kimik) e te agjenteve te ndryshem atmosferike ato kane zokonisht nje siperfaqe jot e lemuar si tek dunitet, por kokrrizore ku kokrrizat e PX formojne relief me te ngritur.

Peridotitet si rregull permbajne sasi te ndryshem px rombik, neshen midis tyre pjese qe permbajne sasi te paket te tije, por ndeshen edhe sektore me permbajtje mesatare apo te larte te tije.

Ne peridotitet e sidomos te atyre te pjeses qendrore, jugore e jug-perndimore te fushes xeherore, jane te shprehura qarte e bukur teksturat paresore te rrjedhjes ne trajte brezash. Ato fgormohen nga vendosja ne forme zinxhiri te kristaleve te Px rombik enstatit, shpesh here ne vijim te njera tjetres ashtu dhe paralel njeri tjetrit. Ne mjaft sektore verehen nderthurje ritmike te brezave te holle te perbere nga peridotite me permbajtje te ndryshme te enstatitit, here me shumice dhe here me pakice, kokrrizat e te cilit orjentoohen ne teresi paralel breznimit. Ndeshen gjithashtu edhe raste kur ato vendosen ne forma mjaft te çrregullta.

Teksturat parcisorc te harcburgiteve kane azimut shtrirje 310-340°, azimut renie 220-250° dhe kend renie qe luhaten nga 30-35° (per pjesen perendimore) deri ne 65-80° per pjesen lindore te fushes xeherore. Ne disa raste vihen re tekstura me kend renie 90° e ngadonjehere me renie veri-lindore, gje qe flet per rrudhosjen e shkembinjve ultrabazike. Ne peridotitet ka raste te shpeshta qe edhe permbajtja e kokrrizave te kromshpinelinit aksesore, e qe ndodhen ne sasi te ndryshme nga 0.5- 1.0 deri ne 3.0 -4.0% e me permasa te rritura mire te vendosura paralel me breznimet e Px e strukturen e pergjitheshme te fushes xeherore.

**Dunitet** . Kane perhapje me te kufizuar se harcburgitet, kane pamje massive me ngjyre vte verdhe, gri ne siperfaqe e te gjelbert te erret ne thyrje dhe ne thellesi.

Dunitet zakonisht ndeshen midis harcburgiteve ne trajte thjerrzash e brezash te ngushte, me permasa nga me te ndryshmet qe luhaten nga disa cm, metra, e deri dhjetra e qindra metra ne shtrirje dhe ne renie. Permbajtjen me te madhe keto shkembinj e kane ne pjesen perendimore te fushes xeherore. Dendur ato ndeshen edhe ne trajte njollash e formash te çrregullta. Ndeshen ne vazhdim edhe ne forme damarash ( seria damarore) qe ne kete rast ato nderpresin te gjitha llojet shkembore ultrabazike ashtu dhe trupat xeherore te kromit.

Ne baze te punimeve te shpimeve e atyre minerare rezulton gjithashtu se shpesh here dunitet mbyllen e pikezohen Brenda intervaleve te shkurtra sin e shtrirje ashtu edhe ne renie. Ndodh qe vete keto forme te tyre te mos kene lidhje me njera tjetren dhe paraqesin ne teresi trajta te nderlikuara. Format e tyre te shumellojshme ndeshen keshtu me shumice, sin e profiling vertical ashtu ne ate horizontal magmatik te kesaj fushe xeherore.

Ne pjesen qendrore e perndimore shpesh here verehen nderthurje te peridotiteve me dunitet. Mirpo edhe ne kete rast dunitet formojne breza e thjerrza qe here-here pykezohen.

Ne teresi shtrirja e brezimeve te duniteve mund te thuhet se I permbahet drejtimit gati gjatesor por me gjithate ndeshen edhe dalje ne drejtim pothuajse gati gjeresor.

Ne dunitet verehen kokrriza te kromshpinelinit e vendosja, shpesh here e tyre ne trajte zinxhiri e paralel njeri tjetrit me gjatesi qe arrijne 1-2 ml here-here dhe me shume me shtrirje 310-340° e renie kryesisht ne J-P qe tregon rrjedhjen dhe levizjen e tyre.

Dunitet si shkembinj monomineralc kane shkalle te ndryshme serpentinizimi, por me gjithate, ato ketij procesi i jane nenshtuar me teper se peridotitet.

Kontaktet e duniteve me peridotitet jane te shumellojshme, here te qarta e te prera dhe here here vihen re zikzake

,dhembezime e nderfutje te shumta njeri tek tjetri, por ndeshen dhe raste kur verehen kontakte graduale mes tyre. Eshte fakt gjithashtu se midis vete shkembinjve dunitike e brenda mases se tyre, shpesh here takohen mbctje te mases se piroksenit si dhe pjese te peridotiteve ne forme thjerrzash te vogla ,shliresh e trajta nga me te ndryshmet. Te tilla argument ate verejtura ne punimet e shumta te shpimeve e atyre minerare flasin qarte se peridotitet e dunitet nuk jane formuar net e njejten kohe dhe se dunitet jane formime me te vonshme se harzburgitet si ato qe ndodhen afer trupave ashtu dhe ato larg trupave xeherore te kromit.

**Piroksenitet.** Keto formime magmatike me pamje massive e daljesh te medha kane perhpje te kufizuar, si dalje me vehte mund te permendim ato qe ndeshen ne pjesen lindore dhe veri-lindore te fushes xeherore. Gjersisht takohen forma damarore e dajkore qe kane gjatesi te ndryshme e qe luhaten nga disa cm deri ne dhjetra e qindra metra trashesi, nga 1-2 cm deri ne 0.8=0.9 ml. Shpesh damarct e pirokseniteve nderpresin njeri tjetrin duke ju dhene shkembinjve ultrabazike nje pamje karakteristike. Piroksenitet, si rregull jane formime me te vonshme sepse ato nderpresin gjithë llojet shkembore ultrabazike ashtu dhe vete trupat e xeheroreve te kromit. Ne pjeset anesore te sgkembinjve kontaktuas verehen ndryshime qe shprehen me serpentinizimin me te theksuar te peridotiteve ashtu dhe duniteve.

Verehen gjithashtu te shperhura formimet e bastitit, kloritit, amfibolit etj. Kontakti mes series dajkore te pirokseniteve e te shkembinjve ultrabazike anesore paraqitet pothuajse gjithnje me dhembezime, nderfutje e zikzake te shpeshta.

**Serpentinitet.** – Kane perhapje te kufizuar. Zakonisht keto formime ndeshen ne zonat tektonike dhe kane trashesi nga me te ndryshmet prej disa ml deri ne 40-65 ml. Serpentinitet jane formuar nga Harzburgitet ashtu dhe nga dunitet. Ne disa sektore ato paraqiten ne forma te brekczuara, kurse ne sektore te tjere ne forma te rrumbullakosura, ovale, me permasa nga me te ndryshmet, e te shoqeruara me te gjitha rastet me material ultrabazik, teper i coptuar qe ne mjaft raste kalojne ne millonitizim.

**Formimet kuaternare.** - Keto formime ne kufijte e fushes xeherore kromitike te Batres zene pjese e sktore te vecante dhe perbehen nga ato deluviale ( gjate shpateve te maleve) nga formime eluviale, ne pjeset e rrafshata te larta ne lindje, veri e veri-lindje te saj ashtu dhe nga aluvialo-proluvile gjate perrenjeve dhe sidomos ne pjeset e poshtme terrijedhes se tyre. Formimet kuaternare ne pergjithesi perbehen nga copra me permasa nga me te ndryshmet nga me te imtat deri ne 0,5-0.6 m rralle edhe me shume, te perziera me produkte te shkaterrimeve ultabazike ( subrrera argjila e produkte kalimtare te tyre).

Trashesia e ketyre formimeve ne teresi sic rezulton nga punimet e shumta te shpimeve, ashtu dhe ato minerare, nuk eshte e madhe dhe luhaten nga disa cm deri ne 1-2 ml deri ne 4-6 ml e rralle me teper. Shkembinjte ultabazike ne disa sektore krahas formimeve kuaternare mbulohen gjithashtu nga pylli e bimesia.

### **Karakteristikat e perdorimit tokes**

Ne zonen ne studim dallohen tokat e kafenjta malore, te murrme pyjore dhe livadhore malore. Shperndarja e tyre i nenshtrohet ligjesise se zonalitetit vertikal. Perhapjen me te madhe e kane tokat e murrme pyjore, si shkembinj amnore te te cilave sherbejne magmatiket dhe pjeserisht terrigjenet.

*Tokat e murrme pyjore* percaktohen si toka te maleve te mesme, te zones se pyjeve te ahut dhe pishes. Jane toka ne proces zhvillimi jo te avancuar, te pasura me minerale, me prirje argjilimi ne horizontet A dhe AB, me reaksion nga acid ne neutral. Pergjithesisht kane cilesi te mira fizike dhe pjellori potenciale te larte. Formula e profilit te ketyre tokave eshte A0-A-B-C ose A0-A-AB- C.

horizonti 0 perfaqeson nje shtrese gjethesh te padekompozuara, horizonti A<sub>0</sub> perfaqeson lenden organike plotesisht te dekompozuar dhe te perzier me fazen minerale te tokes. Ai paraqitet si nje mase e bute dhe e fresket, me ngjyre te erret ne te zeze dhe trashesi 1-3 e deri 15 cm, horizonti A eshte humusor, me trashesi deri ne 30 cm, ngjyre kafe ose te murrme te erret, perberje mekanike subargjilore te mesme dhe strukture kokrrizore, horizonti B eshte iluvial, me trashesi rreth 50 cm ose dhe me shume, me perberje mekanike me te rende se horizonti A per shkak te argjilimit dhe me strukture arnore ne plisore.



*Tokat e Kafenjta Malore* formohen ne kushte te klimes mesdhetare malore dhe paramalore, me regjim hidrotermik te ndryshueshem. Ato formohen kryesisht mbi shkembinj sedimentare dhe me pak mbi ata sedimentare e metamorfike. Ne zonen ne studim jane te formuara mbi eluvim e serpentiniteve. Ato zhvillohen ne brezin e dushqeve, ne kushte te nje relievi heterogjen dhe me pjerresi te theksuar. Per kete arsye jane objek erozioni masiv. Keto toka karakterizohen nga permbajtje mesatare humusi, reaksion nga pak acid ne neutral, kompleks thithes te madh dhe saturim te larte me baza, kryesisht me Mg dhe Ca, horizont iluvial karbonatik, argjilim dhe ngjeshje ne horizontet e mesme te profilit. Formula e profilit eshte A-AB-B-BC-C ose A-AB-BC ose A-AC-C.

### 1.5 -Rezervat gjeologjike dhe te nxjerrshme.

Llogaritja e rezervave gjeologjike eshte bere me metoden e prerjeve veretike dhe horizontale ne varesi te kendit te renies se trupit te kromit. Konkretisht per trupin LII llogaritja eshte bere me prerje vertikale paralele duke pasur te dhena gjeologjike nga kryerja e punimeve minerare se renie e tije eshte 70° ne zonen e profileve -1 deri ne pr. -5, ku jane parashikuar te pergatiten 8400 ton rez. Te kat. B me cilesi ne bllok 38 % Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub> dhe te nxjerrshme 6720 ton me 34.2 % Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>, duke pasur parasysh humbjet dhe varferimin deri ne masen 10 % te cilen e parshikon dhe sistemi I shfrytezimit ne V.burimin e kromit.

Per trupin P.III llogaritja e rezervave eshte bere me prerje horizontale duke pasur parasysh punimet qe jane hapur dhe nga interpretimi ka rezultuar se trupi I mineralizuar ka nje renie te bute reth 15 – 20 grade. Nga zona e pr.V-VII jane parashikuar te pergatiten 13860 ton te kat. C<sub>1</sub> dhe C<sub>2</sub> me cilesi ne bllok 34 % Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub> dhe te nxjerrshme 8127 ton me 30.6%Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub> bazuar ne humbjet dhe varferimin gjate procesit te shfrytezimit.

Gjithesej ne total jane parashikuar te prodhohen 14 847 ton mineral kromi me cilesi mesatare 32.23 % Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>.

### 1.6 Zgjedhja e menyres se shfrytezimit

Elementet e sistemit te shfrytezimit dhe treguesite e priteshem ne project jane percaktuar si me poshte.

Te perdoret sistemi I shfrytezimit me galeri n/kati

Gjatesia e n/kateve per cdo bllok shfrytezimi te jete 40 ml.

Lartesia e bllokut te shfrytezimit te jete 40 ml (sipas kerkese se subjektit +1400-1440)

Ne vartesi te shtrirjes se trupit te mineralizuar te trupit te kromit dhe te tektonikave shkeputese, cvendosjes se tyre ne te dy krahet e trupave ( PIII – LII) mendohet te jene dy blloqe shfrytezimi ku shtrirja totale mund te arrije

nga 20 deri 40 ml, kjo ne vartesi te proceseve tektonike qe kane ndikuar ne kete pjese v.burimi.

Lartesia e n/kateve per mineral do te jete cdo 8 ml

Punimet fushore te shfrytezimit do te sherbejne vetem horizonti I galerise 10-15.

Metrazhi specific I punimeve minerare horizontale e te pjerrta 0,091 ml/ton.

Siperfaqja e lejes eshte kerkuar 0,0116km<sup>2</sup>

Percaktimi i lartesis se n/kateve eshte bere duke pasur parasysh faktoret e meposhtem;

Kushtet tekniko-minerare te objektit.

Vetite fiziko-mekanike te mineralit dhe te shkembinjve rrethues.

Mjetet e ngarkimit dhe te transportit te mineralit dhe sterility.

Kapaciteti ditor dhe mujor ne prodhim mineral kromi.

Ngarkimi dhe transporti i mekanizuar.

Menyra e rezimit : me lende plasese.

Humbjet gjate shfrytezimit : deri ne 10 %.

Varferimi gjate shfrytezimit 8-10 %

### 1.7 Rradha dhe drejtimi i shfrytezimit

Pas kryerjes se unimeve te kerkim-pergatitjes se objektit minerare te cilat kryhen sipas nje programi pune te percaktuar vazhdohet me tej me punimet e shfrytezimit te objektit. Keto punime synojne terheqjen e mineralit te kromit dhe shfrytezimin maksimal te rezervave te llogaritura me pare. Menyra e shfrytezimit nje nder elementet e saj

“ Kaprolla” Permbledhje jo teknike rraportit .


kryesor qe lidhet dhe me Rregullave te sig, Teknin ne pune ka te beje me drejtimin e terheqjes gjate shfrytezimit. Zakonisht teheqjq fillon nga skaji ne drejtim teqendr, por ka raste kur veprohet ne te kundert te kesaj praktike. Ne rastn konkret subjektido te vaproj sipas menyres ng aperiferia ne derjtimte qendres dhc mc pasne drejtim te daljes. Sasia vjetore e prodhimit parashikohet te jete 500-2000 ton ne vit.

Menyra e shfrytezimit te objektit do te jete nga lart poshte, qe nenkupton shfrytezimin me pare te rezervave te mesiprme pastaj atyre ne nivelet me te poshtme

Kushtet tekniko-minerare te shkembinjëve dhe te mineralit qe ndertojne objektin bejne te domosdoshem perdorimin e lendes plasese ne zbulimin dhe rezimin e mineralit.

Pasaporta e shpim –lasjes llogaritjet e lendes eksplozive dhe materialeve plasese, qe do te perdoren.

**Rrezimi me bira marteli** i rekomandohet shoqerise qe te perdoret ne hapjen e rrugeve dhe transheve, pergatitjen e fillimit te shkalles, nivelimin e shesheve te punes, ricoptimin e mineralit me permasa te medha. Kjo metode perdoret edhe per rrezimin e mineralit ne kariera me kapacitet te vogel prodhimi e zbulimi, deri ne kufirin e leverdisc ekonomike kur lind nevoja e perdorimit te mekanizmave



seksion punimi minerare

### 1.8. Llogaritja e koston se prodhimit deri ne produktin e shitshem

